

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

PRIMUS ALBANIA

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L42202028V

NUIS/NIPT

Rruga Margarita Tutulani, pallati Viridario 1

Adresa

Tiranë

Albania

1000

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0697073123

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@primus.com.al

E-mail

Administrator Hrvoje Cabrajic

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/02/01

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0697073123

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-93857-01-26-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Shoqëria Rajonale Ujësjetillës Kanalizime Durrës Sh.A

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

13980000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

“Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/02/14

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2024/01/29

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/29599/01262024

72260000-5

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”
Dokumentet Standarte të Tenderit
Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disë operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)

- Tjetër

□

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

Në datë 29.01.2024 identifikua të publikuar në SEP të APP publikimin e procedurë së prokurimit nr. REF-93857-01-26-2024 me objekt prokurimi “Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së software-ve”, me fond limit 13,980,000 Lek publikuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrëa Sh. A.

Pasi u njohëm me Dokumentet Standarte të Tenderit, evidentuam parregullsitë dhe mangësitë e mëposhtëme.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

I. Në shtojcën 7 Formulari i Termave të Referencës, në kap 2 Rezultatet që duhet të arrihen keni specifikuar detyrat që duhet të realizojë Operatori Ekonomik, si më poshtë:

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga autoriteti kontraktues në mirëmbajtjen e sistemit dhe ofrimin e asistencës teknike:

- Kontrolli, update periodik i serverit;
- Kontrolli i procedurave të backup, restore;
- Mbështetja e përdoruesve gjatë situatave problematike duke realizuar verifikime apo rregullime të ndryshme;
- Realizimi i ndryshimeve dhe përshtatjeve të nevojshme në sistem.
- Perditesimi ne sistem i ndryshimeve te legjislacionit ne lidhje me funksionet e sistemit si faturim, arketim, kontabilitet, llogaritje pagash, burime njerezore, etj.

Ndërsa si në shtojcën 2. Lista e Çmimeve të Shërbimeve ashtu edhe ne Shtojca 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit nuk është përcaktuar një listë e detajuar e shërbimeve që duhet të realizohen, sasia e tyre, afatet e realizimit me qëllim të ndjekjes të zbatimit të kontratës dhe më pas të likuidimit pjesor pas realizimit të shërbimeve të kërkuara.

Përsa më sipër kërkojmë plotësimin/shtimin e tabelës me anë të së cilës të përcaktohen shërbimet e detajuara dhe tabela të jape të paktën informacionin e mëposhtëm:

- i) lista e shërbimeve të kërkuara;
- ii) sasia e shërbimeve të kërkuara (orë/ditë pune, muaj, etj.)
- iii) kolona e çmimeve;
- iv) kolona e vlerave dhe
- v) kolona e afateve te realizimit.

II. Në shtojcën 7 Formulari i Termave të Referencës, në kap 2 Rezultatet që duhet të arrihen keni specifikuar ndër të tjera detyrën e mëposhtëme që duhet të realizojë Operatori Ekonomik: Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga autoriteti kontraktues në mirëmbajtjen e sistemit dhe ofrimin e asistencës teknike:

- Kontrolli, update periodik i serverit;

Ndërkohë në Termat e Referencës (ToRs) nuk janë specifikuar të dhënat teknike të serverit që kërkohet të kontrollohet, etj.

Përsa më sipër kërkohet ndërhyrjen tuaj për plotësimin e ToRs me të dhënat e serverit që AK ka në përdorim ose heqjen e këtij shërbimi nëse është lapsus.

III. Në shtojcën 8 Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), si mëposhtë:

a) Të paktën 2 (dy) zhvillues softëare të certifikuar në nivel eksperti në sistemin aktual ose të teknologjive që përdoren në këtë sistem.

b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher për zbatime/implementime të sistemeve ERP.

c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional në konceptet, inxhinierizimin e Eëb shërbimeve dhe protokollit SOAP ose ekuivalent.

d) Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti të certifikuar në nivel profesionist.

e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

1. Diplomat e shkollës së lartë

2. Certifikatat/transkriptet që vërtetojnë certifikimet e mesiperme të kërkuara

3. Formularet E-SIG për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke iu referuar datës së shpalljes së procedurës.

Ndërsa në proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriterëve për Kualifikim” për stafin ndër të tjera keni argumentuar si më poshtë:

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktuese përcaktojnë kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë duke u bazuar në:

a) Pershtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,

b) Gjendjen ekonomike dhe financiare,

c) Aftësinë teknike dhe profesionale.

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilin nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mesiperme të ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar janë kryer në bazë të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialistëve. Diplomimi i punonjësve në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, migrimin dhe instalimin e të gjithë informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të afroje trajnim për përdoruesit.

a) Punonjësit i kërkuar në pikën ”a” garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE. Disponimi i tyre garanton implementimin, zgjidhjen e problematikave, zgjidhjen e incidenteve gjatë gjithë afatit dhe fazave të kontratës, garanton implementimin e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga AK. Gjithashtu këta specialistë garantojnë vijueshmërinë normale të punës për gjatë

gjithe periudhes se kontrates. Sistemi objekt kontrate sic eshte shpjeguar ne specifikimet teknike ka nevojë per UPGrade dhe ne menyre te tille qe te realizohet me sukses e gjithe procedura dhe brenda afateve te parashikuar eshte i nevojshem disponimi i punonjesve me certifikimet e mesiperme.

b) Punonjësi i kërkuar në pikën "b" vjen si nevojë pasi Implementimi i sistemeve ERP, kërkon njohuri specifike per te cilat lidhet jo vetem me njohjen e sistemeve ERP por edhe me njohjen e praktikave kontabel dhe operacionale te ndermarrjeve sidomos ne rastin e shoqerive te medha dhe komplekse sic eshte SHRUK Durres. Keto njohuri jane specifike dhe te domosdoshme per upgrade dhe mirembajtjen e sistemeve nga te cilat perbehet FLARE ERP. Disponimi i punonjesit me nje certifikim te tille i ofron garanci AK per zbatimin me perpikmeri te kontrates dhe arritjen e rezultateve konkrete.

c) Punonjësi i kërkuar në pikën "c" nevojitet per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme dhe me sistemet e paleve te treta. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara. Ne kete menyre' garantohet integrimi mes sistemeve te brendshme, me institucionet financiare banke dhe jo banke te cilat ka sistemi aktual per te rakorduar automatikisht detyrimet dhe pagesat lidhur me abonentet, integrimi keto qe perdorin protokolle standarte Soap, Rest ose ekuivalente sic eshte cituar dhe ne specifikimet teknike.

d) Punonjësi i kërkuar në pikën "d" garanton AK qe operatori ekonomik ka ne perberje te tij' stafin me aftesi profesionale ne menyre qe i gjithe projekti te realizohet konform te gjitha kerkesave dhe afateve te percaktuara ne DST dhe specifikimet teknike. Punonjesi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerezve dhe burimeve te OE per te patur zbatim te suksesshem te projektit sipas standarteve dhe praktikave me te mira nderkombetare duke marre ne konsiderate rendesine dhe kompleksitetin e projektit. Nje menaxher projekti eshte pergjegjes per ndjekjen e te gjithe ciklit te nje projekti qe prej analizes dhe dizenjimit te kerkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve te programit.

e) Punonjësi i kërkuar në pikën "e" lidhet me rezultatet qe duhet te permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kerkesave te shprehura ne DST ku percaktohen kohet e nderhyrjeve dhe termat e tjera te nivelit te sherbimit SLA (sherbimet e mirembajtjes). Nje certifikim ITIL eshte nje set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh per realizimin e sherbimit ne teknologjine e informacionit dhe komunikimit, qe eshte pjese e qellimit te projektit te autoritetit kontraktor. Kjo kerkese i deshmon autoritetit kontraktor qe operatori ekonomik(nepermjet stafit te certifikuar si me siper, garanton ideimin, konceptimin e sherbimeve IT te projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA, sipas standardeve nderkombetare te njohura, ne gjithe ciklin e tyre, perfshire ketu dhe sherbimet e mirembajtjes qe jane shume te rendesishme per AK dhe te vena ne dukje ne DST dhe specifikime teknike.

Në argumentimin e nevojës për stafin e kërkuar ju keni nënvijëzuar ndër të tjera:

Diplomimi i punonjesve ne deget Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshine implementimin, adaptimin, testimin, migrim dhe instalimin e te gjithe informacioneve teknike te sistemit si dhe duhet te afroje trajnim per perdoruesit.

Të gjitha shërbimet teknike të objektit të prokurimit të cituara në këtë argumentim (të nënvijëzuara) nuk janë pjesë e rezultateve që duhet të arrijë OE/AK të listuara në ToRs, si më poshtë:

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga autoriteti kontraktues në mirëmbajtjen e sistemit dhe ofrimin e asistencës teknike:

- Kontrolli, update periodik i serverit;
- Kontrolli i procedurave të backup, restore;
- Mbështetja e përdoruesve gjatë situatave problematike duke realizuar verifikime apo rregullime të ndryshme;
- Realizimi i ndryshimeve dhe përshtatjeve të nevojshme në sistem.
- Perditesimi ne sistem i ndryshimeve te legjislacionit ne lidhje me funksionet e sistemit si

faturim, arketim, kontabilitet, llogaritje pagash, burime njerezore, etj.

Gjithashtu ju sjellim në vëmendje vendimin e KPP nr. 386/2023, i cili e ka trajtuar dhe dhënë zgjidhje kësaj kërkesë jo reale.

Si rrjedhim, kërkesa për diplomimin e punonjësve nuk është e argumentuar dhe për rrjedhim nuk ka pse të qëndrojë si kriter.

Përsa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit që OE të ketë "... 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj)", si kriter të pabazuar teknikisht dhe në kundërshtim me vendimin e KPP nr. 386/2023..

IV. Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), si mëposhtë:

a) Të paktën 2 (dy) zhvillues softëare të certifikuar në nivel eksperti në sistemin aktual ose te teknologjive që perdoren në këtë sistem.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Diplomat e shkollës së lartë

Certifikatat/transcriptet qe vertetojne certifikimet e mesiperme te kerkuara

Formularet E-SIG per periudhen e 3 (tre) muajve te fundit duke iu referuar datës së shpalljes së procedurës

Ndërsa në proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim” për stafin ndër të tjera keni argumentuar si më poshtë:

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktuese përcaktojnë kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë duke u bazuar në:

a) Pershtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,

b) Gjendjen ekonomike dhe financiare,

c) Aftësinë teknike dhe profesionale.

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilin nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mesiperme të ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar janë kryer në baze të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialisteve. Diplomimi i punonjësve në degët Informatike ose Teknologji-Informacioni ose Elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termit e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshinë implementimin, adaptimin, testimin, migrimin dhe instalimin e të gjithë informacioneve teknike të sistemit si dhe duhet të afroje trajnim për përdoruesit.

a) Punonjësit i kërkuar në pikën ”a”) garanton AK për aftësitë profesionale të punonjësve që ka OE. Disponimi i tyre garanton implementimin, zgjidhjen e problematikave, zgjidhjen e incidenteve gjatë gjithë afatit dhe fazave të kontratës, garanton implementimin e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga AK. Gjithashtu këta specialiste garantojnë vijueshmërinë normale të punës për gjatë gjithë periudhës së kontratës. Sistemi objekt kontrate sic është shpjeguar në specifikimet teknike ka nevojë për UPGrade dhe në mënyrë të tillë që të realizohet me sukses e gjithë procedura dhe

brenda afateve te parashikuar eshte i nevojshem disponimi i punonjesve me certifikimet e mesiperme.

IV/1. Referuar objektit të vetë kontratës të publikuar, rezultateve që duhet të arrijë OE/AK të listuara në ToRs, si më poshtë:

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga autoriteti kontraktues në mirëmbajtjen e sistemit dhe ofrimin e asistencës teknike:

- Kontrolli, update periodik i serverit;
- Kontrolli i procedurave të backup, restore;
- Mbështetja e përdoruesve gjatë situatave problematike duke realizuar verifikime apo rregullime të ndryshme;
- Realizimi i ndryshimeve dhe përshtatjeve të nevojshme në sistem.
- Perditesimi ne sistem i ndryshimeve te legjislacionit ne lidhje me funksionet e sistemit si faturim, arketim, kontabilitet, llogaritje pagash, burime njerezore, etj.

dhe argumentimit të kërkesës për punonjësit sipas gjermës (a) si më poshtë:

a) Punonjësit i kërkuar në pikën "a" garanton AK per aftesite profesionale te,punonjesve qe ka OE. Disponimi i tyre garanton implementimin, zgjidhjen e problematikave, zgjidhjen e incidenteve gjate gjithe afatit dhe fazave te kontratës, garanton implementimin e te gjithe specifikimeve te kerkuara nga AK. Gjithashtu keta specialiste garantojne vijueshmerine normale te punes per gjate gjithe periudhes se kantrates. Sistemi objekt kontrate sic eshte shpjeguar ne specifikimet teknike ka nevoje per UPGrade dhe ne menyre te tille qe te realizohet me sukses e gjithe procedura dhe brenda afateve te parashikuar eshte i nevojshem disponimi i punonjesve me certifikimet e mesiperme.

Rezulton se këta punonjës sipas gjermës (a) nuk do të ofrojnë implementim të sistemeve/ programeve, pasi rezultatet e kërkuara thjeshtë janë në mirëmbajtjen e sistemit. Pra, kërkesa për stafin profesional sipas gjermës (a) është e pargumentuar teknikisht.

Përsa më sipër kërkojmë rishikimin e kësaj kërkesë bazuar në detyrat reale/konkrete që rrjedhin nga ToRs.

IV/2. Keni kërkuar që punonjësit sipas gjermës (a) të jenë "... zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në sistemin aktual ose te teknologjive që perdoren në këtë sistem", por në vijim të kësaj kërkesë nuk është përcaktuar se për kë sistem në përdorim të AK bëhet fjalë, ndërkohë që në ToRs nuk specifikohet teknologjia që është ndërtuar ai sistem i pasaktësuar në këtë kërkesë.

Përsa më sipër, nëse kërkesa për këtë staf qëndron, kërkojmë plotësimin/qartësimin e kësaj kërkesë duke shtuar teknologjinë e ndërtimit të sistemit.

IV/3. Është kërkuar "... zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në sistemin aktual ose te teknologjive që perdoren në këtë sistem". Për ne është e paqartë se çfarë nënkupton kriteri "nivel eksperti". Nëse një punonjës është i çertifikuar sipas çertifikimit të kërkuar, ai çertifikim nuk bën seleksionimin nëse je ekspert ose jo në teknologjinë që është çertifikuar.

Përsa më sipër, nëse kërkesa për këtë staf qëndron, kërkojmë heqjen e togfjalëshit "nivel eksperti".

V. Në shtojcën 8 Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), si mëposhtë:

c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional ne konceptet, inxhinierizimin e Eëb sherbimeve dhe protokollit SOAP ose ekuivalent

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Diplomat e shkollës së lartë

Certifikatat/transcriptet që vertetojne certifikimet e mesiperme te kerkuara

Formulet E-SIG per periudhen e 3 (tre) muajve te fundit duke iu referuar datës së shpalljes së

procedures.

Ndërsa në proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim” për stafin sipas gërmës (c) keni argumentuar si më poshtë:

c) Punonjësi i kërkuar në pikën ”c” nevojitet për të garantuar integrimin mes sistemeve të brendshme dhe me sistemet e paleve të treta. Keto certifikata garantojnë që programuesit janë të aftësuar në zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara. Në këtë mënyrë garantohet integrimi mes sistemeve të brendshme, me institucionet financiare bankë dhe jo bankë të cilat ka sistemi aktual për të rakorduar automatikisht detyrimet dhe pagesat lidhur me abonentet, integrimi këtu që përdorin protokolle standarte Soap, Rest ose ekuivalente sic është cituar dhe në specifikimet teknike.

Referuar objektit të kontratës të publikuar si dhe ToRs, në rezultatet që duhet të arrijë OE/AK nuk bëhet fjalë për integrim mes sistemeve të brendshme (pasi duke i pasur prej kohësh në përdorim të AK besojmë se ato tashmë janë të integruara mes tyre) dhe as për integrimi me sisteme me palë të treta.

Referuar objektit të kontratës të publikuar si dhe ToRs, në rezultatet që duhet të arrijë OE/AK nuk bëhet fjalë për ”... zhvillimin e sistemeve me arkitekture të prirur drejt shërbimeve në rrjet/sistemeve të shpërndara...”, pasi sistemet tashmë janë në përdorim të AK prej shumë kohësh dhe në ToRs është kërkuar thjesht mirëmbajtja dhe përmirësimi i tyre.

Protokolli SOAP është zhvilluar si një gjuhë e ndërmjetme për programet që kanë gjuhë të ndryshme programimi, duke u mundësuar këtyre programeve të komunikojnë me njëri-tjetrin. Në rastin konkret nëse i referohemi disa programeve që ka në përdorim sot AK (Flare ?) përveç se janë të integruara me njëri-tjetrin duhet të jenë ndërtuar në të njëjtën gjuhë programimi, kjo nisur edhe nga fakti i kërkesës së stafit sipas gërmës (a). Pra, kjo kërkesë për staf sipas gërmës (c) është e pargumentuar teknikisht dhe jo në përputhje me rezultatet që duhet të arrijë OE.

Përsa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës për staf sipas gërmës (c) si kërkesë e pargumentuar teknikisht dhe jo në përputhje me rezultatet që duhet të arrijë OE.

VI. Në shtojcën 8 Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në pikën 2.3.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.3.2 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), si mëposhtë:

d) Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti të certifikuar në nivel profesionist.

e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente) Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Diplomat e shkollës së lartë

Certifikatat/transkriptet që vërtetojnë certifikimet e mesiperme të kërkuara

Formularët E-SIG për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke iu referuar datës së shpalljes së procedurës.

Ndërsa në proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim” për stafin sipas gërmës (d) dhe (e) keni argumentuar si më poshtë:

d) Punonjësi i kërkuar në pikën ”d” garanton AK që operatori ekonomik ka në përberje të tij stafin me aftësi profesionale në mënyrë që i gjithë projekti të realizohet konform të gjitha kërkesave dhe afateve të percaktuara në DST dhe specifikimet teknike. Punonjësi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerezve dhe burimeve të OE për të patur zbatim të suksesshem të projektit sipas standarteve dhe praktikave me të mira nderkombetare duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të

gjithë ciklit të një projekti që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

e) Punonjësi i kërkuar në pikën "e" lidhet me rezultatet që duhet të permbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në DST ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirëmbajtjes). Një certifikim ITIL është një set praktikash dhe kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kjo kërkesë i dëshmon autoritetit kontraktor që operatori ekonomik nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin, konceptimin e shërbimeve IT të projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA, sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes që janë shumë të rëndësishme për AK dhe të vena në dukje në DST dhe specifikime teknike.

Referuar objektit të vetë kontratës të publikuar, rezultateve që duhet të arrijë OE/AK të listuara në ToRs, si më poshtë:

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga autoriteti kontraktues në mirëmbajtjen e sistemit dhe ofrimin e asistencës teknike:

- Kontrolli, update periodik i serverit;
- Kontrolli i procedurave të backup, restore;
- Mbështetja e përdoruesve gjatë situatave problematike duke realizuar verifikime apo rregullime të ndryshme;
- Realizimi i ndryshimeve dhe përshtatjeve të nevojshme në sistem.
- Perditesimi në sistem i ndryshimeve të legjislacionit në lidhje me funksionet e sistemit si faturim, arketim, kontabilitet, llogaritje pagash, burime njerezore, etj.

dhe kërkesave funksionale po në ToRs, si më poshtë:

KËRKESAT FUNKSIONALE

Mirëmbajtja e FLARE ERP për sistemet FLARE Accounting, FLARE Billing, FLARE HR & Payroll, Mobiread Kujdes Klienti për 12 muaj nga nënshkrimi I kontratës. Mirëmbajtja duhet të përfshijë garantimin e shërbimit të sistemit 24 orë pa ndërprerje. Kompania e cila bën mirëmbajtjen e sistemit duhet të ofrojë support 24/7 me maksimumi 2 orë kohë përgjigje me mail dhe në raste emergjente kur problemi nuk mund të zgjidhet në distancë me 4 orë kohë përgjigje në vend.

Mirëmbajtja e sistemit duhet të përfshijë update të sistemeve dhe moduleve të FLARE ERP me ndryshimet e legjislacionit për kontabilitetin, legjislacionin e punës, faturimit, arkëtimin.

Mirëmbajtja e sistemit duhet të përfshijë ndihmën në mbylljen e llogaritjeve mujore për faturimin për çështje informatike të cilat nuk mund të mbulohen nga vetë punonjësit e Shoqërisë Rajonale. Këtu mund të përmendim shtimin e artikujve të rinj, ndryshimin e skemës së kontabilizimit të faturimit, arkëtimin etj.

rezulton shumë qartë që ky nuk është një projekt kompleks siç mundohet të argumentohet në proces-verbal ashtu sikurse në vetë rezultatet e pritshme të AK nuk rezulton se duhet angazhimi i një Menaxher Projekti "... që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit...". Siç del qartë edhe nga rezultatet e përcaktuara në ToRs, kontrata është një kontratë e thjeshtë mirëmbajtjeje me disa përditësime në sistem gjithnjë nëse do ketë ndryshime në legjislacion dhe ato do duhet të pasqyrohen në sistem. Pra shërbimet e parashikuara nuk do duhet të nënshtrohen "... analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit...", siç kërkon ndër të tjera një program i ri kompleks dhe për të cilin kërkesa për një Menaxher Projekti do të kishte kuptim.

Ndërkohë nga AK është kërkuar menaxher i shërbimeve të mirëmbajtjes ITIL, detyrat e të cilit pothuajse përputhen në pjesën më të madhe me ato të Menaxherit të Projektit dhe kjo kërkesë për staf sipas gjermës (e) është reale referuar objektit të kontratës të publikuar dhe rezultateve që duhet të arrijë OE/AK.

Përsa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës për staf sipas gjermës (d), si një kërkesë e pargjyentuar teknikisht dhe jo në përpjestim me rezultatet që kërkohen të arrihen nga OE/AK.

VII. Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.4.1 keni kërkuar si më poshtë:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të disponoj Certifikatat për standardet e mëposhtëme, të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim, në përputhje me objektin e prokurimit të kesaj procedure:

? Certifikatën ISO 9001:2015 standardi i menaxhimit të cilësisë (ose ekuivalente e perditësuar)

? Certifikatën ISO/IEC 27001:2013 standardi i sigurisë së informacionit (ose ekuivalente e perditësuar)

Çertifikimet ISO të kërkuara, lëshuar nga organizma certifikues, sipas datës së vlefshmërisë së tyre ose janë të vlefshme ose i ka kaluar afati i vlefshmërisë në datën e përdorimit të tyre për procedurën e prokurimit në fjalë, ndaj cilësimi për to “e perditësuar” është e pakuptimtë dhe mund të krijojë keqinterpretime. Vetë kodi i tyre dhe objekti të cilin ju keni formuluar për çdo certifikatë të listuar jep në mënyrë shteruese dhe paekuivok llojin e certifikatës që ju kërkon.

Ju kujtojmë që ky rast është trajtuar dhe vlerësuar nga KPP me vendimin e tij nr. 386/2023.

Përsa më sipër kërkojmë heqjen e termit “e perditësuar” pas certifikatave të listuara më lart”.

VIII. Në shtojcën 8 Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, kap. I. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.4.2 keni kërkuar si më poshtë:

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributorit për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e programeve kompjuterike FLARE HR & Payroll, FLARE Billing, FLARE Accounting, MOBIREAD të cilët janë sistemet egzistuese që përdoret nga Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres dhe për të cilin do të kryhet mirëmbajtja. Ky kriter plotësohet me dorëzimin e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar për OE pjesëmarrës ku përcaktohen detajet e kësaj procedure dhe kontaktet e subjektit autorizues. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributor i autorizuar të vërtetohet lidhja mes prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Në ToRs, në Kërkesat Funktionale keni qartësuar dhe kërkuar si më poshtë:

KËRKESAT FUNKSIONALE

Mirëmbajtja e FLARE ERP për sistemet FLARE Accounting, FLARE Billing, FLARE HR & Payroll, Mobiread Kujdes Klienti për 12 muaj nga nënshkrimi I kontratës. Mirëmbajtja duhet të përfshijë garantimin e shërbimit të sistemit 24 orë pa ndërprerje. Kompania e cila bën mirëmbajtjen e sistemit duhet të ofrojë support 24/7 me maksimumi 2 orë kohë përgjigje me mail dhe në raste emergjente kur problemi nuk mund të zgjidhet në distancë me 4 ore kohë përgjigje në vend.

Mirëmbajtja e sistemit duhet të përfshijë update të sistemeve dhe moduleve të FLARE ERP me ndryshimet e legjislacionit për kontabilitetin, legjislacionin e punës, faturimit, arkëtimit.

Mirëmbajtja e sistemit duhet të përfshijë ndihmën në mbylljen e llogaritjeve mujore për faturimin për çështje informatike të cilat nuk mund të mbulojnë nga vetë punonjësit e Shoqërisë Rajonale.

Këtu mund të përmendim shtimin e artikujve të rinj, ndryshimin e skemës së kontabilizimit të faturimit, arkëtimit etj.

Ndërsa në proces-verbalin – Tipi i kontratës – Shërbime “Për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për Kualifikim” për këtë rast keni argumentuar si më poshtë:

Argumentimi: Për të garantuar mirëmbajtje të suksesshme sipas kërkesave të AK, duhet që operatori ekonomik të paraqesë dokumenta që bindin se ka të drejtë të punojë e ndërhyjë në sistemet aktuale dhe mund ta zbatojë këtë kontratë sipas pritshmerive të AK.

Në proces-verbal nuk jepet një argumentim dhe vlerësim teknik i plotë, i detajuar dhe shterues që të krijonte bindjen se kjo kërkesë (autorizimi i prodhuesit) është e domosdoshme për këto shërbime të kërkuara, kryesisht mirëmbajtje.

Në zbatim të LPP, vendimeve të ndryshme të KPP dhe vetë DST, referenca për markat që citoni

duhej të ishte shoqëruar me termin “ose ekuivalent”.

Referuar objektit të prokurimit ”Shërbimet e përmirësimit dhe mirëmbajtjes së softëare-ve”, ToRs, shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit dhe kompleksitetin e shërbimeve, volumin e tyre, etj., rezulton që shërbimi kryesor është ai i mirëmbajtjes të sistemit (në disa raste citohen disa sisteme, në disa raste vetëm një i tillë) ndërsa përditësimi i sistemit duket qartë që mund të jetë një rastësi, nëse ndodhin ndryshime në legjislacion, pra jo domosdoshmëri në fazën e përcaktimit të detyrave/rezultateve. Gjithsesi edhe në një rast të tillë ndërhyrjeje në një sistem/program kompjuterik, autoriteti kontraktor zotëron kodin burim të sistemit/programit me anë të të cilit çdo ekspert/subjekt i fushës së IT me kualifikim dhe certifikimet përkatëse mund të ndërhyjë për të kryer ndërhyrjet apo përditësimet e kërkuara.

Ju sjellim në vëmendje vendimin e KPP nr. 386/2023, i cili e ka trajtuar një rast të ngjashëm duke arritur në përfundimin e mëposhtëm:

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon se bazuar në kompleksitetin, volumin dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat për disponimin e punonjësve të certifikuar në kategoritë e kualifikimeve të mësipërme nuk janë të ekzagjeruara dhe përtej asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet, që operatorët ekonomikë ofertues disponojnë stafin me aftësitë dhe ekspertizat e duhura për të zbatuar me sukses kontratën objekt-prokurimi. Por, fakti që autoriteti kontraktor sikurse e ka përcaktuar në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit ka në zotërim një arkivë dixhitale të markës “Flower DMS” dhe një nga zërat e shërbimit objekt-prokurimi është edhe integrimin e sistemit të ri me arkivën dixhitale që disponon, me përcaktimin e kriterit kualifikues të pikës 2.3.4/c të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe gamën e zgjidhjeve të propozuara, pasi për plotësimin e kësaj pikë ofertuesit duhet që të paraqesin certifikata nga prodhuesi i arkivë dixhitale të markës “Flower DMS”, si dhe për më tepër enti prokurues nuk ka argumentuar rëndësinë e vendosjes së kësaj kërkesë për kualifikim lidhur me rëndësinë e kësaj certifikate për realizimin e këtij shërbimi. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë dokumentat e tenderit duke hequr kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.4/c të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit.

Pra, kërkesa 2.4.2 është jo në përputhje me objektivat/rezultatet e kërkuara dhe njëkohësisht e jashtëligjshme.

Përsa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës 2.4.2 si një kërkesë jo në përputhje me rezultatet/objektivat e kërkuara, në kundërshtim me vendimein e KPP dhe me ligjin.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

7. Lista e informacionit konfidencial:

Sipas percaktimeve ligjore

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

info@primus.com.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Hrvoje Cabrajic